



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Plani i Integruar i Ministrisë 2008

Shkurt 2008

Mesazhi i Ministrit

Objektivat themelore për bujqësinë do të njohin hapa të rëndësishme në vitin e tretë të zbatimit të Programit të Qeverisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Rritja e produktivitetit dhe e aftësisë konkurruese të bujqësisë, përmirësimi i standarteve si dhe garantimi i sigurisë ushqimore, përbëjnë sfidat tona më të rëndësishme edhe për vitin 2008.



Specializimi i prodhimit në sektorët e perimeve, vreshtarisë, frutikulturës dhe blegtorisë, përmirësimi i rrjetit të marketingut dhe plotësimi i standarteve të sigurisë ushqimore mbeten në themel të angazhimeve për strukturat e bujqësisë shqiptare.

Rritja e shkallës së mbështetjes financiare të bujqësisë dhe agroindustrisë (kreditimi, skema mbështetje specifike, etj). Në këtë kuadër, skemat e mbështetjes financiare për vreshtarinë dhe pemtarinë përbëjnë një risi të rëndësishme që zë fill në vitin 2007 në politikat tona bujqësore.

Rritja e aftësisë konkurruese të produkteve vendase bujqësore kërkon ndërhyrje të rëndësishme për përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës së marketingut, për rritjen e aksesit të fermerëve në treg, si dhe përmirësimin e menaxhimit të skemave të ujitjes dhe kullimit në të gjithë vendin.

Nxitja e kooperimit si dhe përmirësimi dhe transferimi i teknologjive në prodhim e agropërpunim do të përbëjnë objektiva të tjerë permanentë të institucionit tonë në funksion të rritjes së efektivitetit në bujqësi.

MINISTRI
Jemin GJANA

A handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Jemin Gjani', written over the printed name and title.

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë	4
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	5
3	Programet buxhetore të Ministrisë	7
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008.....	9
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë	15
Aneks 1	Projekt-ligjet për t'u paraqitur.....	16
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European	17
Aneks 3	Investimet publike	21
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj	25
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit	26

1 Misioni i Ministrisë

Misioni i MBUMK është zbatimi i Programit të Qeverisë në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Elementet bazë të këtij misioni janë:

Hartimi dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit në fushën e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit;

Garantimi i shëndetit të njerëzve nga sëmundjet që rrjedhin prej kafshëve dhe sigurimi i cilësisë së ushqimeve nëpërmjet mbrojtjes së shëndetit të kafshëve dhe të bimëve;

Sigurimi i informacionit bujqësor;

Menaxhimi dhe administrimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore;

Asistencë dhe informacion për fermerët;

Menaxhimi i sistemit të kullimit dhe koordinimi i veprimeve për administrimin e sistemit të ujitjes.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e bujqësisë dhe ushqimit

Me vendim të Këshillit të Ministrave datë 14.11.2007 u miratua Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Ushqimit (SSBU), për periudhën 2007-2013. Procesi i zbatimit të saj ka filluar dhe dëshmohet qartë, edhe me anën e mbështetjes direkte të qeverisë për prodhimin bujqësor në shumën prej 860 milionë lekësh, për mbjelljen e pemëve frutore, vreshtave dhe ullinjve, ujitjen me pika në pemtorët intensive, pagesat direkte për krerë lopë në blegtori, etj. Një pjesë e këtyre pagesave fillojnë për herë të parë në vitin 2008.

Strategjia ndërsektoriale e zhvillimit rural

Me vendim të Këshillit të Ministrave datë 14.11.2007 u miratua Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rural (SNZHR), për periudhën 2007-2013. Kjo strategji tani është duke u zbatuar, kryesisht përmes masave të mbështetjes së prodhimit bujqësor.

Strategjia ndërsektoriale e mbrojtjes së konsumatorit

Me VKM nr.797, datë 14.11.2007 është miratuar Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikqyrjen e Tregut, për periudhën, 2007-2013, hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Ekonomisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Kjo Strategji është tani në fazën e zbatimit.

Qëllimet

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Përmirësimi në vazhdimësi i aftësive drejtuese të stafit të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe niveleve të tjera të vendimmarrjes. Afrimi i kushteve të punës me standartet e BE
- Krijimi i një sistemi modern kontabiliteti brenda vitit 2010.
- Krijimi i një sistemi me funksionim të plotë të sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjes së bimëve që mbulon të gjithë vendin dhe monitorimin e tij, kontrolli bashkëkohor në përputhje me standartet e BE deri në 2012 për rritjen e nivelit të mbrojtjes së konsumatorit.
- Rritja e prodhimit bujqësor nëpërmjet plotësimit të nevojave të fermerëve për ujë dhe përmirësimin e kullimit dhe mbrojtjes nga përmytjet e tokave bujqësore. Pavarësi e plotë e shoqatave të përdorimit të ujit dhe bordeve të kullimit në procesin e operimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të transferuara.
- Arritja e progresit teknologjik dhe rritja e prodhimit nga bujqësia, blegtoria dhe agropërpunimi.
- Rritja e cilësisë dhe efektivitetit të veprimtarisë së Qendrave Rajonale të Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe Shërbimit Këshillimor Publik. Numri i projekteve të kërkimit i përputhur me nevojat në rritje të përfituesve, kryesisht në formën e kërkimit të aplikuar. Rritja sasiore dhe cilësore e treguesve statistikorë të sistemit të bujqësisë në funksion të të interesuarve.

- Përfundimi i ndarjes së tokës, dhënies së akteve të tokës në pronësi; krijimi i titujve të pronësisë duke krijuar premisat e një zhvillimi dinamik të tregut të tokës; krijimi i bazës dokumentare të kadastrës së shumëqëllimshme për arritjen e një administrimi të qëndrueshëm në kushtet e privatizimit të tërësishëm të tokës bujqësore, e cila do të arrihet nëpërmjet krijimit të sistemit të informacionit tokësor dhe futjes në sistemin e GIS-it.
- Mbrojtja e fondit të tokës bujqësore bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Sigurimi i fondeve dhe drejtimi i tyre në zonat rurale për realizimin e planeve të veprimit në rajonet pilot.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të MBUMK. Kjo do të arrihet nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në zbatimin e politikave dhe strategjive të ministrisë që mundësojnë përmbushjen e standarteve që rrjedhin nga nënshkrimi i MSA-së si dhe garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare të ministrisë.

3.2 SIGURIA USHQIMORE DHE MBROJTJA E KONSUMATORIT

Politika në fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit synon: përmirësimin e kuadrit ligjor duke e përshtatur atë me legjislacionin e BE-së; hartimin dhe zbatimin e programeve kombëtare të kontrollit të sëmundjeve të kafshëve e parazitëve në bimë, programeve të monitorimit të sëmundjeve, mbetjeve në kafshë dhe në produktet ushqimore me origjinë shtazore; monitorimin e ujrave e molusqeve bivalve; vendosjen në shkallë kombëtare të sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave e forcimit të karantinës veterinarë e fitosanitare; përdorimin e praktikave të mira në mbrojtjen e shëndetit të bimëve; fuqizimin e rrjetit laboratorik e ngritjen e nivelit profesional të stafit veterinar, të shërbimit të mbrojtjes së bimëve dhe sigurisë ushqimore; vendosjen e sistemit të vetëkontrollit dhe gjurmueshmërisë së produkteve ushqimore; ngritjen e sistemit RAPID ALERT dhe futjen e tij në rrjetin European si dhe informimin në kohë të konsumatorit.

3.3 MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË KULLIMIT DHE UJITJES

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin e politikave kombëtare për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytja, reformimin e menaxhimit të sistemit të ujitjes, kullimit e mbrojtjes nga përmytja duke transferuar përgjegjësitë e ujitjes tek shoqatat e përdoruesve të ujit dhe përgjegjësitë e kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja tek bordet e kullimit.

3.4 ZHVILLIMI RURAL DUKE MBËSHTETUR PRODHIMIN BUJQËSOR, BLEGTORAL, AGROINDUSTRIAL DHE MARKETINGUN

Politika e këtij programi konsiston në krijimin e mjedisit për modernizimin dhe përmirësimin e procesit teknologjik, rritjen e prodhimit dhe konkurrueshmërinë e produkteve agro-industriale, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së teknologjisë dhe infrastrukturës së tregut. Politikat do të fokusohen gjithashtu në blegtori, nëpërmjet ruajtjes së resurseve gjenetike autoktone dhe ndërtimit të hallkave të reja për zbatimin e programit racor.

3.5 KËSHILLIMI DHE INFORMACIONI BUJQËSOR

Politika e programit konsiston në mbështetjen me shërbime falas të fermerëve, në funksion të shtimit të prodhimit, rritjes së aftësisë konkurruese dhe rritjes së të ardhurave të fermës në mënyrë të qendrueshme, nëpërmjet transferimit të teknologjive (kryesisht në formën e kërkimit në fermë), mbështetjen e shërbimeve të ekstensionit dhe agrobiznesit me ekspertizë teknike dhe sigurimit të të dhënave statistikore me

besueshmëri të lartë (në përputhje me standartet e Eurostat-it) për sistemin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3.6 MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I TOKËS BUJQËSORE

Politika e programit: Reforma e tokës, tregu, administrimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e tokës bujqësore përbëjnë strukturën themelore të menaxhimit të tokës si pjesë me rëndësi e drejtimit të strategjisë për zhvillimin afatmesëm të bujqësisë. Krijimi i Sistemit të Informacionit të Tokës (LIS) duke e futur në sistemin e GIS-it. Baza e përcaktimit të ecurisë në këtë fushë rezulton bazuar në Programin e Qeverisë për periudhën 4 vjeçare, i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në shtator 2005 si dhe Planin Kombëtar për zbatimin e MSA-së (kapitulli i I-rë "kriteret politike")

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008. Këto produkte përbëjnë Planin e Monitorimit të Ministrisë.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës:

Organizimi i trajnimeve në masën 50% për stafin e ri dhe ekzistues dhe instalimi në masën 35% i rrjetit të sistemit të bujqësisë.

Mbikqyrja e trajnimit të 100% të stafit që merret me financat dhe kontabilitetin e MBUMK.

Përmirësimi i kategorizimeve të pagave (nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë) për nëpunësit civil të aparatit.

Produktet që do të ofrohen

- Blerje softë informatike dhe paisje kompjuterike
- Detyrime vjetore financiare për pjesëmarrjen e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë

4.2 SIGURIA USHQIMORE DHE MBROJTJA E KONSUMATORIT

Objektivat e politikës

- Mbajtja nën kontroll e situatës epidemiologjike për sëmundjet dëmtuese në kafshë e dhe sëmundjeve zoonotike
- Ngritja dhe modernizimi i laboratorit të analizave cilësore të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe mbetjeve të tyre në bimë.
- Krijimi i një sistemi informacioni për shërbimin e mbrojtjes së bimëve.
- Luftimi i parazitëve të veçantë në bimët bujqësore dhe krijimi i zonës së mbrojtur për prodhimin e patates së pastër për eksport.
- Rritja e efektivitetit të punës së laboratorëve të kontrollit ushqimor dhe veterinar.
- Rritja e efektivitetit të punës së inspektorëve të sigurisë ushqimore.
- Informim dhe sensibilizim i publikut në lidhje me sigurinë e produkteve ushqimore.

Produktet që do të ofrohen:

- Përafrimi i legjislacionit në fushën e veterinarisë, mbrojtjes së bimëve dhe sigurisë ushqimore me atë të BE-së; (20 rregullore)
- Realizimi i identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale, realizimi 100% i identifikimit të kafshëve gjedhë, 480.000 krerë dhe regjistrimit të fermave blegtorale. Realizim deri në 250.000 krerë të imta të matrikulluara në rrethet e jugut (vazhdimësia e projektit). Vendosja e database të identifikimit në të gjithë vëndin.
- Realizimi i imunizimit të bagëtive të imta në gjithë rrethet e jugut të vendit nga sëmundja e brucelozës si dhe gjurmimin e gjithë të imtave për brucelozë në rrethet e veriut ku % e infeksionit është e ulët (do të realizohet këtë vit mbështetur me buxhetin e miratuar për 1 milion të imta të vaksinuara dhe 180 mijë krerë të gjurmuara). Uljen e infeksionit të plasjes në nivele të pakonsiderueshme (0,002%)

duke mbajtur nën kontroll me vaksinimin e mbi 1 milion krerëve, ruajtjen e nivelit të sëmundjes së tbc në masën 0,05% nëpërmjet gjurmimit dhe eliminimit të kafshëve të infektuara (60 mijë krerë gjurmime në vatra), ruajtjen në nivele të pakonsiderueshme për sëmundjet e tjera të mbuluara nga shteti.

- Hartimi dhe realizimi në masën 100% i programeve të monitorimit të mbetjeve në kafshët e gjalla dhe produkteve me origjinë prej tyre. Hartimi dhe zbatimi i programeve të monitorimit në ujra e molusqe bivalve.
- Staf i trajnuar në kontrollin e sëmundjeve dhe në inspektimet sanitaro veterinarë (seminar mbi murtajën klasike të derrave, influencës aviare, brucelozës, inspektimeve sanitaro veterinarë) e fitosanitare, dhe i gatshëm për ndërhyrje emergjente për eradikimin e sëmundjeve të rrezikshme në kafshë e bimë.
- Blerja e 10 pajisjeve për modernizimin e laboratorit të analizave cilësore të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe mbetjeve të tyre në bimë.
- Luftimi i parazitëve të veçantë në bimët bujqësore dhe krijimi i nje zone të mbrojtur për prodhimin e patates së pastër për eksport;
- Rritja e efektivitetit të punës së laboratorëve të kontrollit ushqimor, duke përmirësuar paisjen e laboratorit të ISUV me aparatura të reja;
- Rritja e efektivitetit të punës së 120 inspektorëve të sigurisë ushqimore;
- Ndërrmarrja e 3 fushatave për informimin dhe sensibilizimin e publikut në lidhje me sigurinë e produkteve ushqimore;
- Pëcaktimi i 20 specialistëve për monitorimin e sëmundjes së influencës aviare.

4.3 MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË KULLIMIT DHE UJITJES

Objektivat e politikës

- Rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes (me pjesëmarrje në financim edhe të shpu-ve dhe fshpu-ve ekzistuese) për 12 000 ha; rritja e qëndrueshmërisë së rezervave ujore dhe e sigurisë së digave të rezervuarëve nëpërmjet rehabilitimit të tyre (8 diga); transferimi i përgjegjësive të operimit e mirëmbajtjes së ujitjes për 10 000 ha tek 3 organizatat e përdoruesve të ujit pilot që do të krijohen në zonën e Lushnjës, Shkodrës e Korçës.
- Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së kullimit e mbrojtjes nga përmytja (ku përfshihen: kanalet kryesore kulluese, argjinaturat dhe pendët në anët e lumenjve, kanalet e ujërave të larta, kolektorët kryesorë të kullimit dhe grykëderdhjet e tyre në det) për 30 000 ha kryesisht në ultësirën perëndimore (Shkodër, Lezhë, Durrës, Lushnjë, Kavajë, Fier, Vlorë) ku veçojmë ndërhyrjen e përqëndruar në Kolektorin Roskovec - Hoxharë në Fier dhe Kolektori Kullues i Myzeqesë në Lushnjë.
- Garantimi i funksionimit sipas kushteve teknike të 28 hidrovoreve dhe rritja e kapacitetit transportues të hidrovorit të Porto Romanos në Durrës duke instaluar 2 elektropompa të reja.
- Menaxhimi tekniko-administrativ (operimi dhe mirëmbajtja, mbikqyrja, transferimi) i infrastrukturës së kullimit e mbrojtjes nga përmytja për 280 000 ha dhe i infrastrukturës kryesore ujitëse (diga, veprat e marrjes së ujit në lumenj) nëpërmjet: Bordeve të Kullimit dhe menaxhimi tekniko - administrativ i infrastrukturës së ujitjes

të transferuar tek shpu-të; fshpu-ve dhe organizatave të përdoruesve të ujit me pjesëmarrjen edhe të Projektit të Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Produktet që do të ofrohen

- 30000 ha sipërfaqe e tokës bujqësore me rrjet kullues të rehabilituar dhe të mirëmbajtur;
- 12000 ha sipërfaqe e tokës bujqësore me rrjet ujitës të rehabilituar (financim total ku përfshihen edhe rehabilitimi i 8 digave);
- 5000 ha sipërfaqe e tokës bujqësore që i përmirësohet siguria mbrojtëse nga përmbytjet lumore dhe detare (financim total ku përfshihen edhe shumë zona të banuara rurale);
- 75000 ha sipërfaqe e tokës bujqësore që kullon me hidrovore;
- 280000 ha sipërfaqe kulluese dhe ujitëse e tokës bujqësore që kryhet shërbimi i kullimit dhe ujitjes nëpërmjet Bordet e Kullimit dhe shpu-ve, fshpu-ve, organizatave të përdoruesve të ujit dhe Projektit të Menaxhimit të Burimeve Ujore (financim total ku përfshihen 200 000 ha në ujitje të menaxhuara aktualisht nga shpu-të dhe fshpu-të si dhe mbështetja që jep PMBU për ujitje për krijimin dhe funksionimin e OPU-it).

4.4 ZHVILLIMI RURAL DUKE MBËSHTETUR PRODHIMIN BUJQËSOR, BLEGTORAL, AGROINDUSTRIAL DHE MARKETINGUN

Objektivat e politikës:

- Rritja e të ardhurave të fermerëve nëpërmjet rritjes së sipërfaqeve në vreshtari, pentari dhe ullinj me rreth 500 ha, bazuar në skemën e mbështetjes me VKM Nr.3 dt. 10.1.2007.
- Rritja e sipërfaqeve në 10% krahasuar me vitin 2007, për prodhimin e farës së duhanit në stacionin e duhanit Cërrik, i cili është i çertifikuar nga ESHFF: pajisje laboratorit me aparatura të reja; dhomë kondicionimi për përgatitjen e mostrave për kontrollin analitik.
- Përmirësimi i tregtimit të produkteve blegtorale duke ndërtuar një thertore me standartet e BE-së, ku nga ana teknike përgjigjet siguria ushqimore.
- Mbështetje për ruajtjen e racës autoktone të buajve në zhdukje nëpërmjet mbarështimit dhe ushqimit në rrethet Fier, Tiranë, Elbasan, si dhe krijimi i një pike kultivimi të linjave të pastra të farës së mëndafshit.
- Përmirësimi i tregtimit të fruta-perimeve sipas standarteve të BE-së, duke ndërtuar një treg të fruta-perimeve.
- Riciklimi i vlerave monetare në formën e kredisë me qëllim përdorimin e tyre në agro-industri për ngritjen e rreth 10 linjave të përpunimit të fruta-perimeve nga projekti 2KR.
- Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare, për promovimin e produkteve bujqësore dhe agro-industriale.
- Ngritja e Agjensisë së Pagesave e cila do të shërbejë për financimin e fermerëve duke identifikuar dhe mbështetur inisiativa rurale sipas zonave fermere potenciale për aktivitete si agroturizëm etj.
- Programi i zhvillimit të qëndrueshëm të zonave malore SDRMA ka objektiv rritjen e të ardhurave për ekonomitë fshatare në zonat malore të Shqipërisë.

Produktet që do të ofrohen:

- Mbjellja e rreth 2000 ha pemë frutore, vreshta dhe ullinj
- Investim për ngritjen e një thertore të tipit A;
- Pjesëmarrje në panairët kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Ngritja e dy tregjeve për fruta perime;

4.5 KËSHILLIMI DHE INFORMACIONI BUJQËSOR

Objektivat e politikës:

- Ofrimi i paketave teknologjike bujqësore në përgjigje të nevojave të fermerëve duke përmirësuar dhe ofruar rreth 20 paketa teknologjike.
- Zbatimi i paketave teknologjike të përmirësuara dhe të ofruara nga QTTB-të për rreth 6000 fermerë ose kontaktimi i 10% të fermerëve nga Shërbimi Këshillimor.
- Sigurimi i aksesit për informacion për fermerët dhe aktorë të tjerë të interesuar të sistemit bujqësor nëpërmjet kontaktimit nga Shërbimi Këshillimor të rreth 60 mijë fermerëve.

Produktet që do të ofrohen:

- Gjenerimi/përmirësimi i 20 teknologjive të reja të (kërkimi i aplikuar) të zbatuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë;
- Ndërtimi i 2535 metër katrore (m²) ambienteve të reja ;
- Rikonstruktimi i 1932 metër katror (m²) ambienteve ekzistuese;
- Blerje e 51 pajisjeve elektronike;
- Blerje e 72 pajisjeve dhe orendi zyrash për QTTB Vlorë, Shkodër dhe Korçë;
- Traktor 100 kf (kuaj fuqi) dhe 9 agregate shtesë;
- Zbatimi i 30 kërkimeve në fermë në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë;
- Testimi dhe rekomandimi nga QTTB-të i 20 llojeve më të përshtatshme të bimëve dhe kafshëve;
- Kontaktimi direkt i rreth 60 mijë fermerëve përmes aktiviteteve të ekstensionit;
- Realizimi i 21 botimeve;

4.6 MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I TOKËS BUJQËSORE

Objektivat e politikës:

- Për reformën e tokës:
 - Vënia në funksion e përfundimit të procesit të ndarjes së tokës të të gjitha strukturave shtetërore të ngarkuara nga ligji për ndarjen e tokës.
 - Harmonizimi i veprimtarisë së organeve të qeverisjes qendrore për zgjidhjen e konflikteve të pronësisë mbi tokën.
 - Monitorimi i zbatimit të dispozitave ligjore në ndarjen e tokës.

- Për tregun e tokës:
 - Harmonizimi i veprimtarisë me ZQRPP për vijimësinë e Regjistrimit Fillestar në zonat kadastrale rurale dhe evidentimi i transaksioneve për tokën bujqësore.
- Për administrimin e qëndrueshëm të tokës:
 - Vijimi i krijimit të Sistemit të Informacionit Tokësor (LIS) në komuna dhe qarqe të tjera të vendit duke siguruar mbështetje financiare të kësaj veprimtarie.
 - Monitorimi i zbatimit të dispozitave ligjore për kalimet e tokave dhe ndryshimit të kategorisë së resurseve.
 - Përmirësime në kuadrin ligjor që rregullon funksionimin e strukturave shtetërore të administrimit të tokës.
- Për mbrojtjen e tokës:
 - Vënia në funksion dhe trajnimi i strukturave të mbrojtjes së tokës.
 - Financimi i investimeve dhe shpenzimeve të nevojshme për strukturat e mbrojtjes së tokës.
 - Monitorimi i gjendjes së fondit të tokës bujqësore dhe masat ligjore të mbrojtjes së saj.

Tabela 1: Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, milion Lek

Programet	Pagat dhe kontribute të sigurimeve shoqërore 600, 601	Mallra dhe shërbime 602	Subveconet 603	Të tjera transfertë korrente 604, 605	Transferta për buxhetet familiare dhe individët 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	136	63	0	13	0	15	227
Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	773	414	0	0	0	245	1,432
Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	325	418	0	0	0	1,636	2,379
Zhvillimi Rural duke mbështetur prodhimin bujqësor Blegtorial, agroindustrial dhe marketingun	18	31	0	0	860	541	1,450
Këshillimi dhe informacioni bujqësor	166	60	0	0	0	59	285
Menaxhimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore	9	0	0	0	0	0	9
Total	1,427	986	0	13	860	2,496	5,782

5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Identifikoni produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

Treguesit	Njësia	Objektivi
Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes		
Sipërfaqe e tokës bujqësore me rrjet kullues të rehabilituar dhe të mirëmbajtur	ha	30 000
Sipërfaqe e tokës bujqësore me rrjet ujitës të rehabilituar	ha	12 000
Rehabilitimi i digave të rezervuarëve	cope	8
Mbështetja e prodhimit bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingu		
Tokë bujqësore e mbjellë me pemë frutore vreshta dhe ullinj	ha	1200
Ujitje me pika në pemtore	ha	240
Pagesa direkte për lopë në blegtori	krerë	8300
Tregje me shumicë për fruta dhe perime	numër	2
Këshillimi dhe informacioni bujqësor		
Teknologji të reja të gjeneruara/përmirësuara	numër	20
Kërkime në fermë të zbatuara	numër	30
Fermerë të kontaktuar direkt për këshillim	numër	60000
Siguria ushqimore		
Laboratorë të pajisur me aparatura	copë	12
Kafshë të identifikuar gjedhë	krerë	390000
Kafshë të identifikuar të imta	krerë	250000

Aneks 1 Projekt-ligjet për t'u paraqitur

PROJEKTLIGJE

- Projekt-ligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9362, datë 24.03.2005, “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”.
- Projekt-ligj “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe projekt-ligj “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8053, dt.21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”.
- Projekt-ligj “Për materialin mbjellës bimor”.
- Projekt-ligj Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9308, dt. 4.11.2004 “Mbi shërbimin dhe inspektoriatin veterinar”.
- Projekt-ligj “Për plehrat kimike”.
- Projekt-ligj Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8411, dt. 11.10.1998 “Mbi ushqimet në blegtori”.
- Projekt-ligj “Për disa ndryshime në ligjin nr.8880, datë 15.4.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”.

PROJEKTVENDIME

- Projektvendim “Për strukturën, funksionimin, kriteret e pranimit, të vlerësimit të dokumentacionit të nevojshëm dhe të detyrimeve të organizmave certifikues “
- Projektvendim “Mbi kërkesat për ngarkesat mikrobike në qumështin e konsumit dhe të produkteve me bazë qumështi”
- Projektvendim “Për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale”
- Projektvendim “Për miratimin e rregullores për regjistrimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve (PMB)”.
- Projektvendim “Për miratimin e rregullores për importimin, tregtimin, transportin, përdorimin dhe asgjësimin e PMB -ve”
- Projektvendim “Mbi kërkesat teknike në qumështin e papërpunuar që përdoret për qumështin e trajtuar termikisht dhe në prodhimin e produkteve me bazë qumështi”
- Projektvendim “Për tregëtimin e farave të drithërave dhe bimëve foragjere”
- Projektvendim “Për materialet e shumëzimit të perimeve, që janë të ndryshme nga farat”
- Projektvendim “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe rregullat e detajuara për krijimin e Rregjistrimit të Vreshtave e të Verës”
- Projektvendim “Për tregëtimin e materialeve të shumëzimit të bimëve drufrutore”
- Projektvendim “Për zbatimin e programeve për ruajtjen in-situ të racave autoktone të bagëtive të imta”
- Projektvendim “ Për disa ndryshime në vendimin nr.219, datë 16.05.2002 të Këshillit të Ministrave“ Për mbrojtjen e racës autoktone të buajve nga zhdukja”.

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin European

Akreditimi i laboratorëve të kontrollit të ushqimeve të blegtorisë, të materialeve racore, dhe të ushqimeve.

Trajnim për zbatimin e programeve “in situ” të racave autoktone të bagëtive të imta.

Funksionimi i zyrave për mbajtjen e Kadastrës së vreshtarisë dhe verës.

Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës për projekt ligjin për përmirësim të ligjit nr. 8880, datë 15.4.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”.

Ngritja dhe funksionimi i trupës së inspektimit dhe certifikimit për farërat dhe për materialin mbjellës të drufrutorëve.

Ngritja dhe funksionimi i zyrave për mbajtjen e kadastrës së vreshtarisë dhe verës.

Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës për përgatitjen e draftit të VKM “Për strukturën, funksionimin, kriteret e pranimit, të vlerësimit të dokumentacionit të nevojshëm dhe të detyrave të organizmave certifikuese vendase për produktet BIO”.

Vazhdim i funksionimit të grupit të punës për përgatitjen e projekt akteve të paketës ligjore për materialet mbjellëse bimore.

Akreditimi i laboratorëve në kuadër të AKU dhe forcimi i sistemit të kontrollit të sigurisë ushqimore në kuadër të AKU.

Pajisje me aparatura dhe me reagente.

Trajnim për stafin e Drejtorisë së Sigurisë Ushqimore, të laboratorëve, për inspektorët dhe për stafin veterinar.

Identifikimi i gjedhit në 100% të masivit të vendit (470000 krerë).

Realizim i identifikimit i të imtave në 10 rrethe të tjera të vendit të 250000 krerëve.

Emergjencë për sëmundjet e influencës aviare, aftës epizootike dhe sëmundjeve zoonotike problematike (20 % e totalit të nevojave për kontrollin e situatës epizootike).

Gjurmim i brucelozës (180000 krerë të imta, 10000 gjedhë) dhe i tuberkulozit (në gjedhë 60.000 krerë).

Kontrolli i zoonozave problematike për vendin.

Realizimi i programeve kombëtare të monitorimit të ujërave, molusqeve dhe mbetjeve në kafshët e gjalla e produkte (100% në zbatim të programit vjetor).

Vaksinim kundër plasjes (1000000 krerë kafshë të llojeve të ndryshme, të imta, gjedhë, derra, njëthundrakë), kundër murtajës klasike në derra (50000 krerë), dhe 1000000 krerëve të imta në jug të vendit kundër brucelozës.

Monitorimi dhe luftimi i parazitëve të veçantë në bujqësi.

Zbatimi i masave të veçanta në zonat e mbrojtura (Divjakë për pataten dhe perimet).

Rregullore mbi regjistrimin e stabilimenteve të shpendëve të prodhimit, mbuluar nga Dir. 1999/74/EC.

Ngritja e modernizimi i laboratorit cilësor të PMB-ve dhe mbetjeve të tyre në bimë dhe/ose në produkte bimore.

Rregullore mbi testimin e migrimit të përbërësve të materialeve plastike në kontakt me ushqimin.

Rregullore mbi çlirimin e substancave N-nitrosamina dhe N-nitrosatable nga elastomeret ose përbërësit plastikë.

VKM mbi kërkesat teknike që duhen përmbushur për prodhimin e qumështit të trajtuar termikisht dhe prodhimin e produkteve me bazë qumështi.

Rregullore mbi organizimin e tregut të përbashkët të mishit të dhenve.

Rregullore mbi standardet minimum të mbarështimit të kafshëve shtëpiake (shpendë, derra, të imta).

Rregullore që vendos rregulla të detajuara për implementimin e Rreg. 176/2000/EC sa i takon nivelit minimal për kontrollin e kryer për sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të gjedhit.

Rregullore mbi përshtatjen e Dir. 2002/04/EC mbi regjistrimin e stabilimenteve të pulave të prodhimit, mbuluar nga Dir. 1999/74/EC.

Rregullore që përfshin një dokument deklarimi dhe kontrollin veterinar mbi kafshët që hynë në KE nga vendet e treta nga rre.2004/282 CE

Amendim i vendimit 2002/657/EC në lidhje me kuadrin e kërkesave minimale për përmbushjen e limiteve (MRPLs) për disa mbetje në ushqimet me origjinë shtazore. dec 2004/025 CE

Rregulla për nivelet maksimale të mbetjeve (MML) të PMB-ve në ushqimet për njerëz dhe kafshë me origjinë bimore dhe shtazore; miratim nga ministri MBUMK.

Forcimi i sistemit të monitorimit dhe zbatimit të masave në lidhje me standardet minimale të mbarështimit të kafshëve.

Rregullore mbi materialet që përmbajnë derivate të caktuara epoksi dhe që janë në kontakt me ushqimin.

Rregullore mbi artikujt qeramikë në kontakt me ushqimet.

Rregullore mbi materialet e përbëra nga filmat celulozë të rigjeneruar në kontakt me ushqimin.

Rregullore sistemi autokontrollit tek prodhuesit e produkteve me bazë qumështi.

VKM “Për strukturën, funksionimin, kriteret e pranimit, të vlerësimit të dokumentacionit të nevojshëm dhe të detyrave të organizmave çertifikues vendase për produktet BIO”.

VKM “Për procedurat e ndryshimit të fondit kullosor, tarifat për kullotje dhe përdorim të tokës”.

Amendimi i ligjit “Për mbrojtjen dhe zhvillimin e bimëve mjekësore natyrore.

VKM “Për hartimin e zbatimin e Programit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave, programet e zhvillimit në nivel rajoni”.

Nxitja dhe mbështetja për krijimin dhe forcimin e shoqatave racore në fushën e blegtorisë.

Lista e territoreve nga të cilat importi i disa llojeve të peshkut, vezëve dhe gametave të tyre është i autorizuar nga KE. dec. 2006/0680 CE

Rregullore që vendos rregullat e importit të spermës së kafshëve shtëpiake e të llojit të gjedheve. dec. 2004/639 CE

Rregullore mbi implementimin e rregullores mbi vendosjen e matrikujve, pasaportën dhe regjistrin. reg.2004/911CE, dec. 2006/028

Rregullore mbi financimin e inspektimeve të shëndetit për mishin e freskët të pulës.

Rregullore mbi masat shtesë në lidhje me kontrollin e produkteve ushqimore.

Rregullore mbi metodat e marrjes së mostrave dhe analizave për monitorimin e produkteve ushqimore të përcaktuara për konsum njerëzor.

Vendim mbi implementimin e programeve të mbikëqyrjes së influencës aviare në pula e shpendë te egër. Dec.2006/0101

Vendim i komisionit 11 Gusht 2006 mbi disa masa mbrojtëse në lidhje me HPAI tipi H5N1 në shpendët e egër në Komunitet dhe që shfuqizon vendimin 2006/115/KE. Amendim i vendimit 2005/692, 2005/733 dhe 2006/7/KE mbi disa masa në lidhje me HPAI.

Vendim i komisionit 14 Qershor 2006 mbi disa masa kalimtare në lidhje me HPAI në pula ose shpendë të tjerë në komunitet. dir 2006/416 CE

Kriteret e klasifikimit të vendeve të treta sa i takon HPAI dhe ND lidhur me importin e pulave dhe vezëve. dec. 93/0342 CE

Rregullore mbi kontrollin e influencës aviare që hedh poshtë rreg. 92/40/KE. Dir. 2005/94 CE

Organizimi i kontrollit veterinar të kafshëve që vijnë nga vendet e treta. Dir. 91/0496 CE

Përmirësim i ligjit nr. 8880, datë 15.4.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve” dhe Aktet nënligjore që rrjedhin nga ligji.

Amendimi i “Rregullores për Inspektimin Karantinor Fitosanitar”, miratim me VKM .

Rregulla për miratimin e zonave të mbrojtura, të ekspozuara ndaj rreziqeve të veçanta të shëndetit të bimëve; miratim nga ministri.

Rregulla për vendosjen e një sistemi detyrues të regjistrimit të importuesve të bimëve dhe produkteve bimore, miratim nga ministri.

Krijimi i sistemit databazë për regjistrimin e të dhënave që lidhen me regjistrimin e importuesve të bimëve dhe produkteve bimore (lidhja me sistem të PKK).

Krijimi i sistemit databazë të Inspektoratit të Mbrojtjes së Bimëve dhe lidhja në sistem unik komunikimi.

Rregullore mbi kërkesat për t'u regjistruar dhe mbajtur librin gjenealogjik për racat e pastra dhe dokumentacionin zooteknik.

Lista e vendeve të treta të cilat pulat, vezët për shtrim, zogjtë 24 orësh, mishi i pulës, shpendët e egër, mund të importohen në vendet e BE-së. Dec. 06/0696 CE

Miratimi i manualit diagnostik për influencën aviare siç parashikohet në Dir. 2005/94/KE. dir.2006/437 CE

Lista e vendeve të treta ose pjesë të tyre si dhe kushtet e çertifikatës veterinare nga të cilat KE mund të importojë disa kafshë të gjalla dhe mish të freskët. Dec.79/0542 CE

Mbi ndalimin e përdorimit në ferma të disa substancave me veprim hormonal ose rirostatik dhe beta agonist dhe shfuqizimi i Dir. 81/602/KE etj. Dir.96/0022 CE

Udhëzim për plotësimin e listës së varieteteve të materialeve të shumëzimit të bimëve.

VKM për materialet e shumëzimit të perimeve që janë të ndryshme nga farat.

Udhëzim për rregullat e kontrollit për materialet e shumëzimit të perimet, të ndryshme nga farat dhe për materialet e shumëzimit të bimëve drufrutore.

Rregulla mbi lëvizjen e bimëve të caktuara, produkteve bimore dhe/ose objekteve të tjera nëpërmjet një zone të mbrojtur, si dhe lëvizjes së tyre, që origjinojnë nga, dhe lëvizin brenda zonave të mbrojtura; miratim nga ministri.

Mbështetje në praktika të planeve të zhvillimit rural në nivel lokal në bashkëpunim të ngushtë me popullsinë rurale dhe aktorë të tjerë që veprojnë në këtë fushë, në kuadër të zbatimit të planit të veprimeve të Strategjisë së Zhvillimit Rural.

Kontrolli zooteknik e veterinar që zbatohet në tregtinë intrakomunitare të kafshëve të gjalla dhe produkteve prej tyre në lidhje me plotësimin e tregut të brendshëm.

Dir.90/425 CE

Mbi përcaktimin e nivelit dhe frekuencës së marrjes kampionaturave parashikuar ne Dir. 96/23/KE për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve në produkte shtazore.

Kushtet e shëndetit të kafshëve që rregullojnë tregtinë intrakomunitare dhe importet nga vendet e treta të pulave dhe vezëve për shtrim. Dir.90/539 CE

Mbi rregullat e detajuara për implementimin e rreg. 820/97/KE për zbatimin e sanksioneve minimale administrative në punën e vendosjes së sistemit të identifikimit dhe regjistrimit të fermave të gjedhit. Rreg. 98/0494 CE

Rregulla për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e PMB-ve; miratim nga ministri.

Rregulla për kontrollin e breshkëzës së Kalifornisë (San Jose); miratim nga ministri.

Forcimi i sistemit të informacionit bazë për kafshët që përmbushin kërkesat për t'u regjistruar dhe mbajtur librin gjenealogjik (për racat e pastra) dokumentacioni zooteknik.

Rregullore mbi aromatizuesit tymues.

Rregullore për tregtimin e ushqimeve të thjeshta.

Rregullore për inspektimin e të ushqyerit të kafshëve.

“Rregullore mbi inventarizimin e burimit të materialeve dhe substancave të përdorura në përgatitjen e aromatizuesve”.

Aneks 3 Investimet publike

Emërtimi i projektit të investimit	Plani 2008 në 000/lekë
Planifikimi, menaxhimi, administrimi	15000
Zbatim i projektit të lidhjes me intranet në 35% të institucionit	15000
Siguria Ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	95250
Shtesë Zyresh	1000
Blerje pajisje për laboratorët në rrethe	10000
Blerje aparature HPLC për leximin e instaminës(ISUV)	6000
Blerje pajisje laboratorësh për rrethet (ISUV)	4000
Ngritja dhe pajisja e Lab cilësor të PMB dhe mbetjeve të tyre në bimë	54200
Përshtatje e ndërtesës dhe infrastrukturës për Lab Cilësor të PMB	7480
Blerje pajisje aparatura e instrum analit për Lab Cils të PMB	46720
Blerje gjeneratorësh për laboratorët rajonale	2200
Blerje Gjenerator DRBU Dibër	400
Blerje Gjenerator DRBU Gjirokastër	1800
Blerje kondicioner për laboratorët rajonalë	2400
Kondicioner DRBU Berat	200
Kondicioner DRBU Dibër	1000
Kondicioner DRBU Shkodër	1200
Ndërtime, rikonstruksione, përshtatje ambjentesh në DRBU	2700
Rikonstruksion I Rrjetit Elektrik të gjithë Zyrave DRBU Berat	200
Ndërtim-Rikonstruksion zyra e sektorë DRBU Elbasan	2500
Blerje kioska për doganat	1600
Blerje kioske doganë Kukës	1000
Blerje kioske për doganën Sarandë	600
Blerje pajisje elektronike për zyra	5700
Blerje pajisje elektronike për DRBU Berat	500
Blerje pajisje kompjuterike DRBU Dibër	800
Blerje pajisje elektronike për lidhje interneti DRBU Durrës	1000
Blerje pajisje elektronike për zyra DRBU Gjirokastër	500
Blerje pajisje kompjuterike për sektorët DRBU Lezhë	1000
Blerje pajisje kompjuterike DRBU Shkodër	500
Blerje pajisje elektronike për zyra DRBU Vlorë	1000
Blerje pajisje kompjuterike Enti I Farnave	400
Blerje pajisje për zyra	5450
Blerje pajisje zyresh DRBU Berat	350
Blerje pajisje zyresh DRBU Dibër	400
Blerje pajisje zyresh DRBU Elbasan	1000
Blerje pajisje zyresh DRBU Fier	500
Blerje pajisje zyresh DRBU Gjirokastër	700
Blerje pajisje zyresh DRBU Korçë	500
Blerje pajisje zyresh DRBU Kukës	1000
Blerje pajisje zyresh DRBU Shkodër	500
Blerje pajisje zyresh DRBU Tiranë	500
Projekti i Gripit të Shpendëve	10000
Kosto Lokale	3000
TVSH	7000
Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit	736050
OBJEKTE TË KULLIMIT për Bordet e Kullimit	33000
Thellimi,zgjerimi,disiplinimi i lumit Drin i Lezhës, Lezhë	25000
Sistemi kullues zona Tropojë, Kukës	3000

Sistemi kullues zona Kukës, Kukës	2500
Sistemi kullues zona Has, Kukës	2500
OBJEKTE TË MBROJTJES NGA PËRMBYTJET për Bordet e Kullimit	262000
Rikonstruksion dhe ndërtim argjinate të lumit Kir, Shkodër	20000
Mbrojtje nga lumi Buna fshati Shirgj-Dajç, Shkoder	13000
Riparim i Argjinate të Prroit të Rrjollit, Shkodër	5000
Argjinatura lumit Mat, Lezhë	35000
Ndërtim argjinate në lumin Shkumbin në Labinot, Elbasan	6000
Ndërtim argjinate në lumin Shkumbin në Grekan, Elbasan	14000
Ndërtim argjinate në lumin Shkumbin në Jogodin, Elbasan	15000
Ndërtim penele në lumin Vjosë, Fier	25000
Mbrojtje nga përmytjet në lumin Osum, Berat	24000
Mbrojtje nga lumi Shkumbin zona Kavajë	10000
Mbrojtje nga lumi Shkumbin zona Peqin	5000
Rikonstruksion Argjinate të lumit Drinos (Karjan), Gjirokastër	5000
Sistemimi i shtratit të lumit Drinos (zona qytet), Gjirokastër	6000
Mbrojtje nga gërryerja e fushës Andon Poci, Gjirokastër	5000
Mbrojtje e fushës Katundishtë, Permet	4000
Argjinatura Selevëc -Panaja, Vlorë	5000
Argjinatura Vallto - Oriku, Vlorë	1000
Argjinatura e lumit Shushicë (K.D, K.M), Vlorë	6000
Mbrojtje nga lumi I Kalasës, (Pjesa II), Sarandë	10000
Mbrojtje nga lumi Pavell e Madhe, Sarandë	7000
Mbrojtje nga lumi Bistrice e Vogël, Sarandë	3000
Argjinatura lumit Droje (Fush-Krujë), Durrës	4000
Argjinatura bregdetare, Durrës	2000
Argjinatura në lumi Dunavec, Korçë	4000
Argjinatura në lumin Devoll, Korçë	3000
Argjinatura në Përroin Qinam	2000
Argjinatura në Përroin Helmes	1000
Mbrojtje brigjesh nga lumi Drin i Zi Zbinec	3500
Mbrojtje brigjesh nga lumi Drin i Zi Podgorice	3500
Argjinatura mbrojtëse me penele Tërthore Gjoricë	3000
Mbrojtjet nga lumi Erzen (zona Vishaj), Tiranë	5000
Mbrojtjet nga lumi Zhllimë (Veskie), Tiranë	3000
Mbrojtjet nga lumi Zhllime (Mustafa Koc), Tiranë	2000
Mbrojtja e argjinate të Volorekës nga filtrimet	2000
OBJEKTI HIDROVORE për Bordet e Kullimit	46000
Blerje elektropompa për Hidrovorin Porto-Romano, Durrës	30000
Rikonstruksion i Hidrovorit Porto-Romano, Durrës	6000
Rikonstruksion të hidrovoreve Synej dhe Greth, Kavajë	2000
Rikonstruksioni i hidrovorit të Cukës, pjesa e II, Sarandë	4000
Blerje paisje elektromekanike për hidrovoret Tërbuf e Karavast	2000
Blerje elektromotor për hidrovorin Akerni	2000
OBJEKTI MAKINERI, PAISJE, RIKONSTRUKSIONE për Bordet e Kullimit	12500
Rikonstruksion zyrash	3000
Ndërtim zyrash të Bordit të Kullimit Elbasan, Elbasan	4000
Blerje paisje makineri, pjesë ndërrimi	1500
Blerje paisje zyrash	2000
Blerje paisje kompjuterike dhe elektroteknike	500
Blerje paisje zyrash	500
Blerje paisje kompjuterike për zyrat	1000
STUDIME E PROJEKTIME për objekte 2008- 2009 në Bordet e Kullimit	22550
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Berat	1200

Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Durrës	2000
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Elbasan	1500
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Fier	2000
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Gjirokastër	1200
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Kavajë	1200
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Korçë	1150
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Kukës	600
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Lezhë	3500
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Lushnjë	1500
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Mat	1000
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Pogradec	400
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Sarandë	1500
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Shkodër	2000
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Tiranë	600
Studim, projektim të objekteve për 2008-2009, Vlorë	1200
Projekti i menaxhimit të Burimeve Ujore	360000
Kosto Lokale	200000
TVSH	160000
Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, agroindustrinë dhe marketingun agrar	230250
Vazhdim ndërtim tregu rajonal në Berat nga viti 2007	10000
Vazhdim ndërtim thertore Leskovik nga 2007	500
Ndërtim thertore në Kamëz	8500
Impiant teknologjik në thertoren Kamëz	8500
Studim fizibiliteti për tregun bujqësor Lezhë	150
Studim fizibiliteti për tregun bujqësor Peshkopi	150
Projektim Treg bujqësor shumice në Lezhë	1500
Projektim Treg bujqësor shumice në Peshkopi	1500
Ndërtim Tregu Bujqësor shumice në Peshkopi	35000
Ndërtim Tregu Bujqësor shumice në Lezhë	35000
Studim për zhvillimin rural " Mbi Agjensinë e pagesave"	5000
Rikonstruksion objekti i Stacionit të duhanit Cërrik AKDC	200
Blerje pajisje zyre e kompjuterike për AKDC	400
Blerje Video projektor për AKDC	120
Blerje pajisje që sigurojnë energji për AKDC	130
Projekti i MADA (SDRMA)	53000
Kosto Lokale	23000
TVSH	30000
Projekti 2KR	45000
Kosto Lokale	45000
TVSH	0
Projekti ASP(Shërbimet Bujqësore)	25600
Kosto Lokale	21600
TVSH	4000
Këshillimi dhe informacioni bujqësor	59150
Ndërtime të reja në QTTB -të(sera, magaz, mure rrethues)	21350
Ndërtim sere perimesh 650m2, dhoma e mbirjes+ magazin përpunimi 100m2	7000
<i>Rikonstruksion I stall nr 4, Depart Blegtorisë QTTB Korçë</i>	2350
Ndërtim, Rrethim I bazës eksperimentale Lushnjë	5000
Ndërtim muri rrethues , QTTB Fushë -Krujë	1500
Ndërtim rrjeti kompjuterik, QTTB Fushë- Krujë	2500
Ndërtim magazine drithi QTTB Lushnjë	3000
Rikonstruksione ambjentesh ekzistuese në QTTB-të	16850

Rikonstruksion çatie, QTTB Korçë	1000
Rikonstruksion zyra e laboratorë, QTTB Shkodër	7000
Rikonstruksion stalle nr. 2 , QTTB Korçë	3000
Rikonstruksion godine, zyra Dep blegtorisë , QTTB Korçë	3000
Rikonstruksion magazine, dep blegtorisë, QTTB Korçë	2000
Rikonstruksion qendër brigade për punëtorët, QTTB Korçë	850
Blerje pajisje laboratorit për QTTB-të	3250
Blerje pajisjelaboratori invitro, QTTB Vlorë	1700
Blerje pajisje laboratorit, QTTB Fushë-Krujë	1000
Blerje pompe zhytëse , QTTB Korçë	550
Blerje pajisje elektronike për QTTB-të	4600
Blerje pajisje kompjuterike për Qendrat e Informac Bujqësor (DRBUMK)	3600
Blerje kompjutera , QTTB Fushë-Krujë	500
Blerje kompjutera , QTTB Korçë	500
Blerje pajisje e orendi për QTTB-të	3100
Blerje pajisje e orendi zyrash , QTTB Shkodër	2000
Blerje pajisje e orendi zyrash, QTTB Vlorë	400
Blerje pajisje e orendi , QTTB Korçë	700
Blerje makineri të rënda dhe agregate bujqësor për QTTB-të	10000
Blerje agregate bujqësore, QTTB Lushnjë	4000
Blerje traktori 100 KF , QTTB Korçë	3400
Blerje agregate bujqësore, QTTB Korçë	2600
T otali	1135700

Në Programin “Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit” me shpenzimet (art. 602) do të kryhen punime të mirëmbajtjes me vlerë 243.5 milionë lekë të Sistemeve Kryesore Kulluese si më poshtë:

Shpenzimet në Kullim

- Pastrimi i Kolektorit Roskovec - Hoxharë, Fier 64.5 milionë lekë
- Pastrimi i Kolektorit të Myzeqesë dhe sistemet kryesore, Lushnjë 66.5 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Lezhë e Kurbin 22 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Berat e Kuçovë 13 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Korçë 13.5 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Shkodër 11 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Durrës 11 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Elbasan 8.5 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Vlorë 8.5 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Sarandë 8 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Gjirokastrë 3 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Mat 3.5 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Pogradec 3.5 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Tiranë 3 milionë lekë
- Sistemet Kulluese Kryesore në Kavajë 4 milionë lekë

Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

Emërtimi i projektit të investimit	Plani 2008 në 000/lekë	Lloji i financimit
Siguria Ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	150000	
PIU Gripi i shpendëve	40000	GRAND
PIU Gripi i shpendëve	110000	KREDI
Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit	900000	
PIU Menaxhimi i Burimeve Ujore	900000	KREDI
Zhvillimi rural duke mbështetur prodhimin bujqësor, blegtoral, agroindustrial dhe marketingun	309000	
PIU 2 KR	100000	GRAND
PIU Zhvillimi i Qëndrushëm i Zonave Malore	209000	KREDI
Totali	1359000	

Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

Botimi dhe shpërndarja e Udhëzimit të MBUMK dhe MF mbi mbështetjen e prodhimit bujqësor

Botimi dhe shpërndarja e një fletëpalosje për zbatimin e fondit të mbështetjes për prodhimin bujqësor

Hartimi dhe publikimi i raporteve periodike mbi zbatimin e mbështetjes shtetërore për prodhimin bujqësor

Monitorimi i zbatimit të mbështetjes për prodhimin bujqësor duke përfshirë edhe përfituesit

Rishikimi i tarifave për materialin mbjellës bimor

Thjeshtimi i procedurave të lejeve dhe licencave ose kthimi i tyre në autodeklarim

Shqyrtimi i vlefshmërisë ligjore të krijimit të pronësisë mbi tokën bujqësore